
SPECIALTY LANGUAGES AND THEIR REPORT VERSUS THE STANDARD LANGUAGE GJUHËT E SPECIALITETIT DHE RAPORTI I TYRE KUNDREJT GJUHËS STANDARD

ENKELA DALIPI

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Italiane , Tiranë, ALBANIA
keladalipi@yahoo.it

AKTET V, 4: 630-633, 2012

PËRMBLEDHJE

Në shoqërinë e sotme globale të komunikimit, ku tregu i punës bëhet gjithnjë e më shumë kompleks dhe ndërveprues, gjuhët e specialitetit marrin një rëndësi të veçantë. Përmes këtij punimi, do të analizohet natyra, klasifikimi dhe karakteristikat leksikore, gramatikore dhe tekstuale të gjuhëve të specialitetit, për te verifikuar shkallën e ndryshueshmërisë së tyre kundrejt gjuhës bazë. Gjatë punimit janë sjellë pikëpamje të ndryshme, shpesh edhe kontraktore të zërave akademikë më të spikatur të fushës së linguistikës, lidhur me përcaktimin dhe funksionimin e gjuhëve të specialitetit brenda kornizës së gjuhës bazë.

Fjalë kyçe:juhët e specialitetit, didaktika e mikrogjuhëve, gjuha standart, vecori leksikore, sintaksore.

SUMMARY

In today's society of communication, where the job market becomes increasingly complex and interactive, specialty languages receive a special attention. The aim of this project is to analyze the nature, the classification and different lexical, syntactic and textual features of specialty languages in order to verify their degree of variability versus the standard language. In the course of this project different views are brought, even contradictory ones of the most prominent academi voices of linguistics, regarding the definition and functioning of specialty languages inside the frame of basic language.

Key words: Languages for Specific propose, didactics of microlanguages, basic language, lexical, syntactic and textual features.

1. HYRJE

Interesi për gjuhët e specialitetit shfaqet që në dhjetëvjetarët e parë të shkencës linguistike. Në fakt, që në vitet Njëzetë e Tridhjetë të shekullit të kaluar studiuesit e Shkollës se Pragës u morrën me të ashtëquajturin 'stil funksional', tipik i gjuhës së shkencës dhe teknikës. Qëndrimi fillestar ishte i tipit konservator dhe prirëj t'i paraqiste këto gjuhë në një nivel më inferior dhe qartësisht të ndara nga gjuha e zakonshme. Më vonë ato u konsideruan si sisteme parciale brenda gjuhës bazë, me të cilën vendosin kontakte dhe shkëmbime.

Gjuhët e specialitetit, edhe nga vetë përcaktimi, lindin nga nevoja për të komunikuar në mënyrë

të qartë, të përpiktë, dhe transparente në fusha të caktuara.

2. METODOLOGJIA E PUNIMIT

Kërkimi i një linje interpretuese, dhe jo thjesht deskriptive, mbi veçoritë gjuhësore-pragmatike të gjuhëve të specialitetit qëndron në themel të këtij punimi. Kjo rrugë argumentative ling nga përcaktimi i problemeve duke i analizuar ato gjithmonë në rrafshin krahasues: raporti gjuhë bazë/gjuhë specialiteti.

Së pari e kam parë të nevojshme të qartësoja, duke studiuar literaturën përkatëse, konceptin e vetë gjuhëve të specialitetit, duke përcaktuar raste dhe klasifikime, duke vënë në dukje madje

edhe divergjencat apo vështirësitë e hasura në këtë drejtim nga studiues të ndryshëm të fushës. Komplexiteti i gjuhëve të specialitetit nxit analizën e shumë aspekteve që nga ato leksikore, morfosintaksore dhe tekstuale. Një ndarje e tillë adoptohet thjesht për motive të një praktikiteti më të madh dhe lehtësive në trajtimin e argumentave, pasi ato janë ngushtësisht të ndërlidhura mes tyre në mënyrë konstante.

Gjithashtu, duke qënë e angazhuar në procesin e mësimdhënies, më ka ardhur për ndihmë edhe eksperiencia didaktike në mësimdhënien e një gjuhe të specialitetit, ç'ka më ka lejuar të sjellë përjasjen mes pjesës teorike dhe pjesës praktike.

3. PËRKUFIZIMI I TERMIT “GJUHË TË SPECIALITETIT”

Ekziston një çështje terminologjike lidhur me përkufizimin e gjuhëve të specialitetit, të cilat përgjithësisht quhen edhe *mikrogjuhë*, apo *gjuhe sektoriale*, në ambjentin anglosakson *gjuhë për qëllime të veçanta*, ku fjala kyçe është pikërisht qëllime, pra një gjuhë e cila u intereson atyre të cilët kanë qëllime të caktuara për të mësuar një gjuhë. Pavarësisht nuancave që marrin këto terma, dhe që janë objekt i studimeve të shumta, jo pjesë e këtij punimi, ajo që i bashkon është pikërisht aspekti funksional: pra janë gjuhë të cilat përdoren më një funksion specifik e që shpesh janë të pakuptueshme për individë të cilët nuk janë pjesë e sektorit.

Le të sjellim disa përkufizime të zërave akademikë bashkëkohorë më të spikatur lidhur me Gjuhët e specialitetit.

Paolo Balboni, një studiues i glotodidaktikës, teksa trajton gjerësisht këtë problem i referohet termit Mikrogjuhë duke propozuar një klasifikim me gjashtë ndarje:

- Mikrogjuha e shkencave juridiko-ekonomike;
- Mikrogjuha e filozofisë dhe e shkencave sociale;
- Mikrogjuha e shkencave natyrore;
- Mikrogjuha e shkencës dhe teknologjisë;
- Mikrogjuha e komunikimit;
- Mikrogjuha e Forcave të Armatosura.

Këto kategori të përcaktuara nga Balboni nuk pranohen apo klasifikohen në mënyrë analoge nga studiues të tjerë të fushës.

Gaetano Berruto duke iu referuar gjuhëve të specialitetit flet për nënkodet, *i përcakton ato si varietete të karakterizuara nga një leksik i veçantë dhe të përdorura për të komunikuar argumentë të lidhur me aktivitete të caktuara profesionale*. Në brendësi të nënkodeve Berruto dallon:

- Gjuhët e veçanta, në sensin e ngushtë të fjalës, nënkode të mirëfillta të cilat dallohen nga një leksik i veçantë dhe nga një morfosintaksë dhe tekstualitet karakteristik;
- Gjuhët e veçanta në kuptimin e gjërë, ose gjuhët sektoriale, të cilat nuk kanë një leksik të caktuar specifik, por janë të lidhura gjithësesi me fusha përdorimi të veçanta jashtëgjuhësore;
- Zhargonet, të cilat kanë një leksik të veçantë me mekanizmat e veta semantikë dhe të fjalëformimit, por pa veçorinë e nomenklaurës, janë të lidhura me grupe apo përdorues, por jo me sfera argumentash dhe fushash jashtëgjuhësore.

Alberto Sobrero, në studimin e tij të vitit 1993 i referohet termit “Gjuhë të veçanta” duke i quajtur ato si një bashkësi të përcaktuar, që përfshijnë në brendësi të tyre varietete të diferencuara. Kriteri i diferencimit është kriteri i specializimit dhe me të Sobrero përcakton dy nënsisteme:

- Gjuhët e specializuara, të cilat i përkasin dhe karakterizojnë disiplina me një gradë të lartë specializimi, sikurse fizika, informatika, gjuhësia, të cilat kanë një leksik specifik dhe rregulla tipike konvencionalisht të caktuara dhe të pranuar, zgjedhje sintaksore të sakta dhe struktura tekstuale të kodifikuara;
 - Gjuhët sektoriale, të cilat i përkasin sektorëve dhe fushave të punës, jo specialistike, që nuk kanë një leksik të vetin specifik, as rregulla të veçanta, por importojnë nga gjuha e zakonshme fjalë, shprehje, metafora e teknikizma. Këtu, Sobrero fut gjuhën e medias së shkruar, të politikës dhe të publicitetit.
- Diferenca më thelbësore mes gjuhëve të specializuara dhe gjuhëve sektoriale sipas Sobreros qëndron në nivelin më të lartë apo më të ulët të leksikut të specializuar, veçori kjo e cila lidhet me modalitetin dhe qëllimet e përdorimit

të tyre. Mesazhet e gjuhëve sektoriale përhapen në pjesën më të madhe të tyre nga masmedia: grada më e ulët e specialitetit të leksikut i detyrohet faktit të kuptimit të tij nga ana e nje publiku më të gjërë, kurse gjuhët e specializuara ruajnë një terminologji lartësisht të specializuar pasi edhe qarkullimi i mesazheve është më i kufizuar dhe i destinuar për ekspertët e fushës.

Gjatë viteve '70 merr jetë perkufizimi "Gjuha për qëllime të caktuara", duke zënë një vend të dukshëm në didaktikën e gjuhëve të huaja. Në vecanti, ky perkufizim i referohet cdo lloj mësimdhënieje e cila ka për qëllim të plotësojë qëllime praktike, të dobishme qartësisht të identifikueshme.

4. KARAKTERISTIKAT E GJUHËVE TË SPECIALITETIT DHE RAPORTI I TYRE KUNDREJT GJUHËS BAZË

Midis veçorive të ndryshme që gjuha zotëron është adaptimi i saj në cdo nevojë komunikimi.

Gjuha, nën influencën e faktorëve jashtëgjuhësore i ruan të paprekura karakteristikat e saj strukturore dhe gramatikore, por vë në përdorim një pasuri leksikore të përshtatshme për qëllime të një komunikimi të caktuar. Jo thjesht folësit kalojnë nga regjistrat informale në regjistrat gjithnjë e më të kontrolluar dhe formalë, por, sipas argumentit në fushën e eksperiencës në të cilën realizohet komunikimi ndodh që përdoret një leksik specialiteti i tillë, me konfiguracionin e një nomenklature të veçantë.

Po cili është raporti mes gjuhës bazë dhe gjuhës së specialitetit? Çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan ato? Cilat janë ato veçori që ndikojnë në sjelljen e diferencave të tyre kundrejt gjuhës së zakonshme, për të prekur së fundmi një çështje të natyrës didaktike për mësimdhënin e këtyre gjuhëve në kontekstin universitar, por që mbetet për t'u trajtuar në një punim të dytë.

Pjesa më e madhe e metodologëve dhe gjuhëtarëve nuk janë dakort me tezën e dallimit rrënjësor që ekziston mes gjuhës bazë dhe gjuhëve të specialitetit. Ky dallim, sipas tyre është thjesht pjesë e një konceptimi të ngushtë të gjuhës që sheh njëtrajshmërinë në një sistem

abstrakt ngushtësisht gjuhësor, pa marrë parasysh përdorimet dhe diversitetin e situatave komunikative, identitetin e bashkëbiseduesëve si dhe qëllimet e tyre komunikuese.

Theksi i vendosur në veçoritë e gjuhëve të specialitetit nxjerr natyrshëm në pah çështjen e lidhjes së tyre me gjuhën "bazë" ose "gjuhën e zakonshme".

Le të sjellim argumente në mbrojtje të kësaj teze duke evidentuar tiparet e përbashkëta dhe ato veçuese midis gjuhës së specialitetit dhe gjuhës bazë.

a) Veçori leksikore të gjuhëve të specialitetit

Gjuhët e specialitetit, në tërësinë e tyre, karakterizohen nga një leksik specifik i cili nuk përkon me atë të përdorur për biseda të karakterit të përgjithshëm. Kjo lidhet me specialitetin e përmbajtjeve dhe të njohurive të përbashkëta të individëve të cilët bëjnë pjesë në një fushë të caktuar.

Në fakt, siç pranohet cdo lloj komunikimi është një komunikim për "qëllime të veçanta", pasi nisët nga qëllime dhe nevoja të caktuara dhe shpreh funksione specifike. Ajo që i bashkon gjuhëtarët është fakti se gjuhët e specialitetit nuk diferencohen në mënyrë cilësore nga gjuha bazë në nivelin fonologjik, morfologjik, sintaksor dhe teskual. Ajo që qëndron pjesërisht specifike është vetëm nënsistemi leksikor. Terminologjia specifike shihet si një komponent i rëndësishëm dhe tipizues i gjuhëve të specialitetit. Kjo terminologji, e predominuar nga teknikizma, përbën një fushë të veçantë leksikore. Kështu, duke iu referuar gjuhës italiane burokratike gjejmë të përdorur terma të tillë si *espletare* kundrejt *svolgere*, apo *quiescenza* kundrejt fjalës *pensione*, apo shembuj leksikorë nga gjuha juridike si: *affliggere la pena* kundrejt fjalës së zakonshme *condannare*, apo në gjuhën e mjekësisë termi '*cavita*' orale kundrejt fjalës *bocca*. Pra fjala kthehet në term, dhe si i tillë ai ndryshe nga fjala ka vetëm një kuptim.

b) Veçori morfologjiko-sintaksore të gjuhëve të specialitetit

Folëm për karakteristikat në nivelin leksikor të gjuhëve të specialitetit, por leksiku nuk është sfera e vetme ku duhet të drejtohem për të evidentuar veçoritë e ketyre gjuhëve. Ka ndryshime mes gjuhës së përditshme dhe gjuhëve të specialitetit edhe në nivelin morfologjiko-sintaksor.

Gjuha bazë dhe gjuhët e specialitetit apo sektoriale, kanë të përbashkët në mënyrë të padiskutueshmë *gramatikën*.

Duhet theksuar se ndryshimet gramatikore i përkasin vetem aspektit sasior, dhe jo atij cilësor. Kështu, në gjuhët e specialitetit vërehet një tendencë më e madhe për sintetizim, ç'ka përkthehet në rrafshin sintaksor me mospërdorjen e elementëve frazorë, mungesën e parafjalëve apo nyjeve, me një përdorim më të madh të emërzimeve, me një përdorim më të dendur të formave foljore të pashtjelluara, predominimi i formave foljore pësore dhe pavetore kundrejt formave vetore. Jo se keto teknikizma nuk gjejnë përdorim në gjuhën e zakonshme, por intensiteti i përdorimit të tyre është më i lartë në gjuhët e specialitetit.

Të gjitha këto teknikizma morfo-sintaksorë, kontribuojnë për të krijuar edhe veçori të tjera, derivat të tyre : psh përdorimi i shpeshtë i formës pasive e kthen tonin e bisedes në neutral, jo personal, me mungesë emocionesh, mbizotëron qëllimi informativ mbi komponentin emotiv ose estetik, mbizotëron sinteza dhe efikasiteti si dhe objektiviteti shkencor.

Pavarësisht veçorive morfosintaksore, gjuhët e specialitetit nuk kanë një sintaksë të tyren tipike. Aty gjejnë përdorim më të gjërë disa struktura specifike, dhe më pak disa të tjera. Pra është çështje e cila i përket një analize të karakterit sasior.

c) Veçori tekstuale të gjuhëve të specialitetit

Së fundmi, gjuhët e specialitetit karakterizohen edhe nga veçori tekstuale. Në këto gjuhë mbizotërojnë rregullat logjiko-semantikore, pra kemi ndarje në paragrafë të cilët janë edhe mbajtës së koncepteve. Fjalja e pare e çdo paragrafi shpreh idenë kryesore.

Një karakteristikë e pare e dukshme në tekstet shkencorë është prania e gjerë e skemave, tabelave, grafikëve dhe ilustrimeve. Një rëndësi të vecantë marrin edhe aspektet e koherences dhe kohezionit tekstual të cilat janë:

- 1) Referenza anaforike, të tipit psh: "shih më lart";
- 2) Funkzioni organizativ i lidhorëve tekstualë të raportit shkak-pasojë;
- 3) Ngurtësia e strukturës tekstuale, bazuar mbi skemën thelbësore me katër pjesë Hyrja-Problemi - Zgjidhja - Përfundimi.

PËRFUNDIME

Në përfundim të këtij punimi mund të themi se raporti midis gjuhëve të specialitetit dhe gjuhës bazë është i ndërsjellte. Gjuha e zakonshme u ofron '*lëndën e parë*' gjuhëve të specialitetit, jo vetëm në nivelin fonologjik/ortografik dhe morfosintaksor, por kryesisht në atë leksikor ku fjala kthehet në term dhe mbart një kuptim të vetëm. Gramatika e gjuhëve të specialitetit është e njëjtë me gramatikën e gjuhës së zakonshme: ajo që ndryshon është frekuenca e ndryshme e përdorimit të formave morfo-sintaksore. Në aspektin leksikor terminologjia specifike shihet si një komponent i rëndësishëm dhe tipizues i gjuhëve të specialitetit, por nuk mund të jetë një element i mjaftueshëm për të përfutur një ndarje të prerë mes gjuhëve të specialitetit dhe gjuhës bazë.

BIBLIOGRAFIA

- BALBONI, Paolo (2000), *Mikrogjuhët shkencore – profesionale: natyra dhe mësimdhënia*, UTET Libreria, Torino.
- BERRUTO, Gaetano (1987), *Sociolinguistika e italishtes bashkëkohore*, Carocci, Roma.
- BERRUTO, G. (19176), *Semantika*, Zanichelli, Bologna.
- CIGADA, S. (1985), *Teksti gjuhësor dhe nivelet e tij të analizës*, Nuova Secondaria.
- CILBERTI, Anna (1998), *Mësimdhënia gjuhësore për qëllime të veçanta*, Zanichelli..